



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 21.1 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike dhe nenit 3.2 dhe 13 të Rregullores nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - KQZ me datë 30.08.2019 merr këtë:

V E N D I M

për shqiptimin e gjobës partisë politike – Partija Kosovskih Srba

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për partinë politike, Partija Kosovskih Srba me akronimin PSK, për sanksionim me gjobë për dorëzimin me vonesë të Raportit Financiar Vjetor të vitit 2018.
- II. Partia politike Partija Kosovskih Srba -PKS, gjobitet me gjobë prej njëmijë e dhjetë euro (1,010.00 €). Gjegjësisht gjobën bazike prej njëmijë euro (1,000.00 €) dhe me gjobë ditore prej 0.01% të shumës bazë për njëqind ditë (100) vonesë, respektivisht dhjetë (10€) euro.
- III. KQZ i transferon të gjitha pagesat e gjobave në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- IV. Obligohet Zyra që ta njoftoj përfaqësuesin e Partisë Politike “Partija Kosovskih Srba -PKS”, për marrjen e këtij Vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Arsyetim

Partia politike, “Partija Kosovskih Srba” me akronimin PKS, e regjistruar më 15 maj 2017, nuk i ka përmbushur detyrimet në përputhshmëri me nenin 3.2, germa b) e Rregullës Nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet për të dorëzuar Raportin vjetor financiar deri me datën 1 mars 2019. PKS, Raportin vjetor financiar në Zyrë e ka dorëzuar me datë 10 qershor 2019, pra me 100 dite vonesë. Në bazë të nenit 13.3 të së njëjtës rregull, PKS si parti politike që nuk është përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, për vonesë të Raportit vjetor financiar gjobitet me gjobë bazike me njëmijë (1000) euro, dhe me gjobë ditore prej 0.01 % të shumë së gjobës bazë, për vonesë 100 ditore. Gjoha e tërësishme për këtë shkelje është 1010 euro.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Valdete Daka, Kryetare

Këshillë juridike: Partia Politike, “Partija Kosovskih Srba” me akronimin PKS, nga pranimiti i këtij vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për për shqiptimin e gjobës partisë politike, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, brenda 24 orëve .